

NJOFTIM
Nr. 1886, datë 22.11.2022

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË 1 (NJË) ANËTARI TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës, në mbështetje të neneve 47 dhe 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të pikave 6 dhe 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, shpall thirrjen, për:

- Fillimin e procedurave të përzgjedhjes së 1 (një) anëtari të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, që përzgjidhet nga studentët e Universitetit të Sporteve të Tiranës

Bordi i administrimit të institucionit të arsimit të lartë është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Funkcionet kryesore të Bordit Administrativ janë:

a) garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;

b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;

c) me propozim të Senatit Akademik miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;

d) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

dh) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

e) jep mendimin për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

f) përcakton rregullat e shpërndarjes së të ardhurave, që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

g) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorit dhe të personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

h) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

i) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t’i përcillet Senatit Akademik;

j) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit të hartuar nga rektorati.

Kriteret për t’u emëruar anëtar i Bordit të Administrimit janë:

a) të ketë integritet etik dhe profesional;

b) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

c) të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe të dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.

Aplikimi për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes së 1 (një) anëtari të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve, përfaqësues të studentëve, duhet të përmbajë:

- kërkesë për pjesëmarrje në konkurrim;

- jetëshkrim, ku ndër të tjera të përshkruhen arritjet në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Arritjet e referuara nga aplikanti, në një apo disa nga këto fusha, të shoqërohen me kopje të noteruara të dokumenteve provuese;

- kopje të dokumentit të identifikimit;

- kopje të noteruar të diplomës së arsimit të lartë;

- kopje të noteruar të diplomës/certifikatës/dëshmisë së nivelit më të lartë të kualifikimit shkencor dhe/ose akademik;

- vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore, sipas formularit bashkëlidhur;

- vetëdeklarim për kushtet e konfliktit të interesave, sipas formularit bashkëlidhur.

Dokumentet për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes së 1 (një) anëtari të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, përfaqësues të studentëve, do të dërgohen përmes shërbimit postar, në adresën:

Universiteti i Sporteve të Tiranës
KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE
Tiranë

Afati për dorëzimin e dokumentacionit fillon më datë 30.11.2022 deri më datë 7.12.2022, ora 12:00.

Lista e kandidatëve, që plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart, do të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës, brenda datës 7.12.2022, ora 16:00.

Lista e kandidatëve që do të përzgjidhen nga studentët e Universitetit të Sporteve të Tiranës, sipas përcaktimeve të pikës 6, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018, të referuar më lart, do të shpallen në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës, brenda datës 9.12.2022, ora 14:00.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE UST
KRYETAR
Denis Nuriu